



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorëzuar Prilijeno/Prodato Received/Delivered	24-07-2023	3	viti god year
Organ/Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojç Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHOK	5342	2023	118



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.824/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.824/2023 të datës 08.06.2023 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga kundër Vendimit Nr.08/27-668-2023 të datës 22.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.07.2023, mori këtë.

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.824/2023 e datës 08.06.2023 e parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet Vendimi Nr.08/27-668-2023 i datës 22.05.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- III. Anullohet Njoftimi për kandidatin e suksesshëm i datës 28.03.2023, faza e testimit me gojë dhe me shkrim si dhe Raporti i përgatitjes së listës së ngushtë i datës 07.03.2023.
- IV. Obligohet Komisioni Përzgjedhës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të ndërmarr veprimet e nevojshme që në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, që të zhvilloj procedurën e rekrutimit për pozitën "Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan", nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë.

**V. Obligohet** Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që të kujdeset që zbatimi i këtij vendimi të bëhet si në pikën IV të dispozitivit.

**VI.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### **A r s y e t i m**

Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 30.01.2023 ka shpall konkursin me Nr. KQZ-06/2023 për pozitën "Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan", i cili ka qenë i vazhduar për shtatë (7) ditës deri më datë 27.02.2023, në të cilin konkurs kanë aplikuar trembëdhjetë (13) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja, ku sipas Raportit të datës 07.03.2023 Komisioni Përzgjedhës ka përgatitur listën e ngushtë, nga rrjedhë se sipas këtij raporti nëntë (9) kandidatë (në mesin e tyre edhe ankuesja) kanë plotësuar kushtet e konkursit ndërsa katër (4) kandidat nuk kanë plotësuar kushtet e konkursit.

Në bazë të provave të lëndës, ankuesja është përfshirë në fazat e procedurës konkretisht listën e ngushtë, testin me shkrim dhe intervistën me gojë. Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit për pozitën e cekur më lartë sipas formularit Form.KQZ-R-10 të renditjes përfundimtare të kandidatëve ankuesja është renditur e treta me pikë me gjithsej 74.2, ndërsa sipas Njoftimit për kandidatin e suksesshëm të datës 28.03.2023, ankuesja nuk rezulton të jetë kandidate e suksesshme.

Ankuesja kundër njoftimit për kandidatin e suksesshëm të datës 28.03.2023, më datë 25.04.2023 ka parashtruar ankesë me Nr. 09/537-2023 në Komisionin për Ankesa të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 22.05.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. 08/27-668-2023 përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuese duke e lënë në fuqi njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 28.03.2023.

Ankuesja kundër Vendimit Nr.08/27-668-2023 të datës 22.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më datë 08.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4630/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 12.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ndërsa Këshilli me datë 15.06.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 4630/2023 e darës 08.06.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.08/27-668-2023 të datës 22.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe

Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Ankesën e datës 25.04.2023 e parashtruar nga ankuesja në Komisionin e Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm i datës 28.03.2023; Kërkesën për rishikim të testit me shkrim e parashtruar nga ankuesja datë 29.03.2023; Njoftimin nga V.B për ankuesen datë 30.03.2023; Njoftimin e ankueses i datës 30.03.2023 për V.B; Shkresë e datës 31.03.2023 nga Komisioni lidhur me shqimin e testit me shkrim nga ankuesja; Kërkesën për qasje në dokumente publike e parashtruar nga ankuesja; Njoftimin nga V.B për ankuesen lidhur me shqyrtimin e kërkesës për qasje në dokumente publike; Emailin nga E.A për ankuesen; Përgjigje në kërkesë e datës 14.04.2023 nga Kryeshefi Ekzekutiv i S-KQZ-së për ankuesen; Kërkesën për fillimin e rekrutimit e datës 30.01.2023; Konkursin e datës 30.01.2023 të shpallur nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Regjistri i Aplikacioneve të pranuar; Përcaktimi i Kritereve për Përfshirje në Listën e Ngushtë i datës 07.03.2023; Lista e ngushtë për pozitën ZLKZ në Lipjan; Formularin për përcaktimin e kritereve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punë për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj i datës 15.03.2023; Formulari për përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve; Formularin për regjistrim biznesi; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 12.06.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 15.06.2023; Njoftimin për vazhdimin e afatit të konkursit; Vendimin me Nr. 02-222-2023 i datës 02.03.2023 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Pikët e kandidatëve për vlerësim të listës së ngushtë datë 07.03.2023; Njoftimin për testin me shkrim i datës 13.03.2023 për kandidatët; Njoftimin e datës 20.03.2023 lidhur me rezultatin e testit me shkrim të dërguar nga Zyra e Personelit për kandidatët; Njoftimin e datës 28.03.2023 për kandidaten e përzgjedhur; Njoftimin e datës 28.03.2023 për ankuesen nga V.B për rezultatin e përgjithshëm; Testin me shkrim të ankueses dhe kandidates së suksesshëm i datës 15.03.2023; Testin me shkrim të miratuar nga Komisioni dhe Çelësin e përgjigjeve të testit me shkrim; Formularin për vlerësimin e kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatët: M.R-B, K.I, L.S, M.J-G, B.B, Sh.D-G, S.R; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm i datës 28.03.2023; Raportin e listës së ngushtë i datës 07.03.2023; Raportin mbi përgatitjen e listës së vlerësimit të testit me shkrim i datës 20.03.2023; Raportin Final i Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues i datës 27.03.2023; Kërkesën për aprovimin e rekomandimit të Komisionit Përzgjedhës i datës 27.03.2023; Emailin e datës 14.04.2023 nga ankuesja për V.B; Kërkesën për punësim i datës 10.02.2023 i kandidates A.A, Deklaratën e datës 10.02.2023, Dokument identifikimi i kandidates A.A, Diplomën me Nr. 174/18, Diplomën me Nr. 172/45-65, Diplomën me Nr. 5483, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 08.02.2023, Vërtetimin e datës 10.02.2023 nga Universiteti i Prishtinës, Vërtetimin nga S-KQZ i vitit 2021, Certifikatën e trajnimit për periudhën 21.10-18.11.2020, Certifikatën shtator 2019, Certifikatën nga EBAA, Certifikatën 08-10.07.2019, Certifikatën e datës 06.07.2019. Certifikatën Nr.2535/2-10, Certifikatën e datës 28.06.2016, Letër reference e datës 06.05.2021, Vërtetimin e datës 14.03.2017, Vërtetimin me Nr. 1-151-39637 i datës 08.11.2016, Certifikatën për periudhën shkurt-korrik 2020, Vërtetim për pranim të aplikacionit për kandidaten A.A i datës 10.02.2023; Kërkesën për punësim e datës 03.02.2023 e kandidates Sh.D-G, Diplomën me Nr.1678, Vërtetim i datës 01.09.2015, Formën e autorizimit i datës 04.01.2023, 30.06.2022, Certifikatën e datës 05.12.2006, Mirënjohje e datës 01.11.2004, CV-në, Dokument identifikimi, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 31.01.2023, Vërtetimin për pranimin e aplikacionit i datës 03.02.2023; Kërkesën për punësim e datës 09.02.2023 e kandidatit S.R, Deklaratën e datës 09.02.2023, Certifikatë e Lindjes e datës 10.02.2023, Diplomën me Nr. 471/21, Diplomën me Nr. 1145/18, Diplomën e datës 14.06.1084, Vërtetimin me Nr. 1/70 i

datës 01.02.2016, Vërtetimin e datës 20.10.2021, Vërtetimin e datës 25.11.2022, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 10.02.2023, Letër rekomandimin e datës 14.09.2018, Referencë e datës 25.11.2022, Certifikatë e datës 05.12.2004, Certifikatën e datës 03.09.2007, Certifikatën e datës 01.10.2018, Diplomën nga The Cambridge School e datës 10.07.2001, Certifikatën 26-28.05.2000, Vërtetimin për pranimin e aplikacionit i datës 10.02.2023; Kërkesën për punësim e datës 14.02.2023 e kandidatit V.B, Dokument identifikimi, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 13.02.2023, Diplomën e datës 02.06.2022, Certifikatën datës 13.03.2016, Diplomën nga the Cambridge School e datës 28.06.2005, 02.03.2004, 16.07.2003, Certifikatën e datës 10.06.2008, 14.06.2007, Diplomën nga Agjencia Doganor JU DHE NE, Referencën e datës 24.04.2008, Referencën e datës 08.02.2008, Forma e vlerësimit të përformancës o datës 03.03.2021, 17.12.2019, Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 29.12.2010 deri 09.02.2023, Vërtetimin e datës 16.12.2021, Diplomën me Nr. K.363/08, Diplomën me Nr. 1769. Diplomën me Nr. 3978; Kërkesën për punësim të datës 02.02.2023 të kandidatit R.R, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 02.02.2023, Diplomën me Nr. 162/45-64, Vërtetimin Ref Nr. 12/616 i datës 01.02.2023, Letër Referencë nga UBT, Vërtetimin V.Nr.59/2018 i datës 26.04.2018, Vërtetimin e datës 02.04.2021, Letër Referencë e datës 18.02.2022, Diplomën nga The Cambridge School e datës 08.03.2013, Certifikatën për periudhën 27-28.06.2017, Mirënjohjen e datës 28.12.2016, Certifikatën për periudhën 06-12.07.2017, Certifikatën qershor 2021, Certifikatën Nr. 2748 prill 2019, Certifikatën për periudhën 03-04.12.2022, Vërtetim për pranim të aplikacionit i datës 02.02.2023, Deklaratën e datës 08.02.2023; Kërkesën për punësim e datës 10.02.2023 e kandidates M.J-G, Deklaratën e datës 10.02.2023, Dokumentin e identifikimit, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 02.02.2023, Vërtetimin e datës 08.02.2023, CV-në, Referencën nga UBT e datës 07.02.2023, Referencën e datës 30.10.2015, Letër Rekomandimin i datës 22.12.2004, Certifikatën e datës 11.06.2019, Certifikatën me Nr. 634/01-06 korrik 2022, Certifikatën e datës 24.06.2019, Vërtetim për pranimin e aplikacionit i datës 13.02.2023, Diplomën me Nr.97/45-64; Kërkesën për punësim e datës 02.02.2023 e kandidatit M.M, Deklaratën e datës 02.02.2023, Dokument identifikimi, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 02.02.2023, Diplomën datës 14.07.2021, Diplomën me Nr. 217, Akt Emërimit e datës 01.05.2013, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 11.01.2023, 31.12.2021, Certifikatën prill 2018, shtator 2016, dhjetor 2015, nëntor 2015, shtator 2012, Certifikatën nga The Cambridge School e datës 21.12.2009, Certifikatën e datës 15.02.2010, Mirënjohjen e datës 31.12.2014, Mirënjohjen 2022, Vërtetim për pranimin e aplikacionit i datës 03.02.2023; Kërkesën për punësim e datës 14.02.2023 të kandidates M.R-B, Deklaratën e datës 14.02.2023, CV-në, Formularin e vlerësimit të punës i datës 13.01.2023, 11.01.2022, Letër Motivimi e datës 10.02.2023, Dokument identifikimi, Diplomën e datës 16.06.2003, Diplomën me Nr. 035/19, Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 01.01.2018 deri 31.01.2023, Kontratë Pune e vitit 2018, Vërtetim punësimi i datës 29.01.2020, Kontratë Pune e datës 01.09.2020, Vërtetim Punësimi i datës 10.02.2023, Certifikatën e datës 03.06.2022, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 01.02.2023, Vërtetimin e datës 01.20.2023, Vërtetimin për pranimin e aplikacionit i datës 14.02.2023, Diplomën me Nr. 5796; Kërkesën për punësim e datës 27.02.2023 e kandidatit M.L, Letër Referencë e datës 01.02.2023, CV-në, Diplomën me Nr.235/13, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 27.02.2023, Dokument identifikimi, Vërtetimi për pranimin e aplikacionit i datës 27.02.2023; Kërkesën për punësim e datës 10.02.2023 e kandidatit L.S, Dokument identifikimi, Vërtetimin Ref.Nr.08/148, Vërtetimin e datës 19.12.2022, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 08.02.2023, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 19.12.2022, 22.06.2021, Vërtetimin për pranimin e aplikacionit i datës 10.02.2023, Diplomën me Nr. 4979; Kërkesën për

punësim e datës 10.02.2023 e ankueses, Deklaratën e datës 10.02.2023, Letër Motivimi e datës 10.02.2023, CV-në, Dokument identifikimi, Diplomën me Nr. 14/45-65, Diplomën me Nr. 639/09, Certifikatën gusht 2017, qershor 2012, prill 2010, Vërtetimi 2021 nga S-KQZ, Vërtetimet S-KQZ i datës 08.06.2021, Vërtetimin e datës 30.11.2014, Kontratë Pune e datës 01.10.2011, Formulari për vlerësim e kryerjes së punës për staf jo permanent për periudhën 02.09.2021 deri 30.11.2021, për periudhën 15.01.2021 deri 10.03.2021, për periudhën 10.09.2019 deri 10.11.2019, Referencë Punë mars 2021, flete rekomandim i datës 10.04.2008, Vërtetimin e datës 25.05.2009, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 01.02.2023, Vërtetimin për pranimin e aplikacionit i datës 10.02.2023; Kërkesën për punësim e datës 09.02.2023 të kandidatit A.B, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 31.01.2023, Diplomën me Nr. 110/16, Diplomën me Nr. 030/12, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 20.12.2022, 21.01.2021, Vërtetim i përvojës së punës me Nr. -2/69 i datës 02.20.2023, Referencë me Nr. -2/68 i datës 02.02.2023, Certifikatën tetor 2019, Mirënjohje e datës 14.09.2020, Shkresë nga NATO e datës 14.10.2010, Letër rekomandimin e datës 31.08.2010, Vërtetimin për pranimin e aplikacionit i datës 08.02.2023; Kërkesën për punësim e datës 13.02.2023 e kandidatit B.B, Dokument Identifikimi, Diplomën me Nr. 810/22, Diplomën me Nr. 985/14, Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 16.08.2017 deri 01.02.2023, Kontratë punë për kohë të pacaktuar e datës 01.07.2017, 01.09.2022, 01.02.2019, Referencën e datës 26.03.2019, Referencën e datës 03.01.2023, Certifikatën për periudhën 26.05-02.07.2016, Letër Referencë e datës 16.06.2016, Certifikatën nga PRIKOS, Certifikatën me Nr. 289, me Nr. 91, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 09.02.2023, Vërtetimin për pranimin e aplikacionit i datës 13.02.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e *bazuar*, sepse:

Kolegji i Këshillit, konstaton se nga përmbajta e konkursit me Nr. KQZ-06/2023 të shpallur më datën 30.01.2023 për pozitën *"Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan"*, kriteret e përcaktuara lidhur me kualifikimet, aftësitë dhe përvojën e punës kanë qenë: *"1. Të ketë diplomë universiteti në lëmin e drejtësisë, ekonomisë, administratës publike, shkencave politike, të drejtave të njeriut, administrim të zgjedhjeve, shkenca sociale, marrëdhënie ndërkombëtare, menaxhment ose statistikë; dhe 2. Së paku katër (4) vite përvojë pune"*.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se gjatë këtij procesi ka pasur shkelje të parimeve të Rregullores Nr. 03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, parimeve të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje e Ligjit Nr.05/L-023 për Mbrojtjen e të Ushqyerit me Qumësht Gjiri dhe shkelje e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil si dhe duke u bazuar në nenin 86 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative"*, do të bëjë shqyrtimin në tersi të procedurës së rekrutimit për pozitën *"Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në*

*Lipjan*" të shpallur sipas konkursit me Nr. KQZ-06/2023 nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Duke marr parasysh dispozitat të aplikuara ligjore në fuqi duke përfshirë edhe aktet e brendshme normative të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kolegji i Këshillit duke mbështetur në Aktgjykimin në rastin nr. KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese të datës 09.07.2020 me Nr.ref.:AGJ 1583/20, dhe në kuptim të normave të brendshme të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ndërlidhen me procedurat e rekrutimit, ju referua Rregullores Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më konkretisht nenit 21 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2, ku përcaktohet se: *"Anëtarët e Komisionit Përzgjedhës vlerësojnë aplikacionet ne baze te kritereve ne vijim: 1.1 Arsimimi dhe kualifikimi profesional i dokumentuar, që konsiston ne vlerësimin e jetëshkrimit te kandidatëve dhe dëshmitë e ofruara për shkollim dhe kualifikime dhe përvojën, vlerësimin e arsimimit dhe vlerësimin e trajnimeve, te lidhura me fushën përkatëse te përgjegjësiwe. 1.2 Përvoja e punës, që konsiston ne eksperiencën përkatëse profesionale dhe menaxheriale, varësisht nga pozita e klasifikuar e punës"*. Bazuar në këtë rregullore, Kolegji i Këshillit, konstaton se lidhur më përvojën e punës për pozitat përkatëse në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, aplikohet sistemi i përvojës së punës profesionale apo menaxheriale dhe kjo varësisht nga shpallja e pozitës dhe nivelit të saj, që në këtë rast pozita *"Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve"* është pozitë e nivelit profesional, mbi këtë bazë edhe përvoja e punës duhet të jetë profesionale.

Andaj Kolegji i Këshillit, lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i themeluar sipas Vendimit me Nr. 02-222/2023 të datës 02.03.2023, më datë 07.03.2023 ka përgatitur Raportin lidhur me listën e ngushtë, duke konstatuar se nga trembëdhjetë (13) kandidatë, nëntë (9) prej tyre janë përfshirë në listën e ngushtë dhe katër (4) nuk janë përfshirë në listën e ngushtë.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, konstaton faktin se në listën e shkurtër janë përfshirë kandidatët si: kandidatja Sh.D-G, kandidatja M.J-G, kandidati L.S dhe kandidatja K.I, të cilët përvojën e punës së fituar në institucionet private nuk e kanë dëshmuar me dokumentacionin e nevojshëm, respektivisht në aplikacionin e tyre nuk ka ndonjë dokument përcjellës nga Trusti i Kursimeve Pensionale apo nga Administrata Tatimore e Kosovës, sepse përvoja e punës në sektorin privat nuk është dëshmi e mjaftueshme dhe e vlefshme nëse të njëjtat nuk janë të shoqëruara edhe me vërtetim nga organet/institucionet përgjegjëse që vërtetojnë çështjen që është objekt i rishqyrtimit sipas asaj që u deklarue më lartë, kështu që lidhur me këtë Kolegji i Këshillit, ju referuar Aktvendimit me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, e cila ka theksuar se dëshmitë e përvojës së punës duhet të dëshmohen me kontratë pune dhe me vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe dëshmi të lëshuar nga Trusti Pensional i Kosovës, detyrim ky ligjor i përcaktuar me nenin 9 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale.

Bazuar në këtë konstatim, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni Përzgjedhës me rastin e përgatitjes së listës së shkurtër përmes të cilës këta kandidat janë përfshirë në listën e ngushtë, nuk ka arritur të dëshmojë në mënyrë të drejtë nëse këta kandidatë plotësojnë kushtet e konkursit

gjegjësisht atë të përvojës së punës, me që rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 21 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 2 të Rregullores Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të pretendimeve ankimore të ankueses për shkelje të parimeve të Rregullores Nr. 03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, parimeve të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe duke marr parasysh dispozitat të aplikuara ligjore në fuqi duke përfshirë edhe aktet e brendshme normative të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe konstatimeve të shkeljeve të paraqitura si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit duke mbështetur në Aktgjykimin në rastin nr. KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese të datës 09.07.2020 me Nr.ref.:AGJ 1583/20, konstatoi se procedura e rekrutimit sipas konkursit me Nr.KQZ-06/2023 për pozitën *"Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan"* të shpallur nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë deri në fazën e përfundimi për arsyet e cekura më lartë është zhvilluar në kundërshtim me nenin 11 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se *"Pranini në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve"* dhe dispozitave të Rregullores Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Nga konstatimet si më sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.08/27-668-2023 i datës 22.05.2023, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Udhëzimin Administrativ (KQZ) Nr.02/2018 për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, prandaj mbi këtë bazë i njëjti është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit, nga konstatimet e lartcekura, konstaton se për shkak të shkeljeve procedurale të cekura si më lartë në këtë procedurë, dhe me qëllim të eliminimit të tyre, Komisioni Përzgjedhës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të ndërmarr veprimet e nevojshme që në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, të zhvilloj procedurën e rekrutimit për pozitën *"Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan"*, nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë dhe të bëjë vlerësimin e aplikacioneve të kandidatëve duke u bazuar në konstatimet si më lartë dhe gjithherë në respektim të normave të përcaktuara me dispozitat e Rregullores Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Lënda, A.nr.824/2023, datë 24/07/2023.

**Avdyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Arben MEHMETI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses,
- Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komisionin Qendror Zgjedhor, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.